

V E N D I M
Nr.596, datë 12.9.1996

**PËR DISA NDRYSHIME NË NDARJEN ADMINISTRATIVO-TOKËSORE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Me propozimin e sekretarit të Shtetit për Pushtetin Lokal, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.269, datë 25.6.1992 “Për ndarjen administrativo-tokësore të Republikës së Shqipërisë”, bëhen këto ndryshime:

Në rrethin e Durrësit

- Fshati Manëz shpallet qytet dhe Komuna Manëz emërtohet Bashkia Manëz.

- Fshati Sukth i Ri shpallet qytet dhe Komuna Sukth emërtohet Bashkia Sukth.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi